

BIBLIOTEKA
SHTETIT

81H-1
R 63

LUAN REXHEPI

Rrugë
dhe këngë
poëzi



814-1

R 63

LUAN REXHEPI

RRUGE DHE KENGË

- poezi -



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

G A T I S H M Ě R I

Jo, nuk jam i lodhur
Nga leximet,
Librat s'dua
Në sirtar t'i fus,
Në një kohë
Q'atdheu zhvillon stërvitje
Dhe me kazëm
Dhe me pushkë!...
Dua përsëri
Në orën tre të natës,
Të më zgjojë
Çang' e kapanonit,
Perëndim' i diellit
Të më gjejë
Për në kthim
Nga zon' e poligonit!...
Dhe shok të bëhem
Me prodhimin,
Unë t'i fal
Një vezme poetike,
Dhe ai
Kujtimin të ma kthejë

Me një palë syze
Antioksidrike! . . .
Dua me shërbim
Gjith' qenien time
Ta dërgoj kudo,
Ku ndihet kazma,
Dashurinë —
Poshtë, nëpër miniera,
Fantazinë —
Lart, nëpër tarraca! . . .
Dua me një bllok
Të pluhurosur
Rrugën e marshimeve
Të marr. . .
Të më thërrasë n'apel
Revolucioni:
— Ju, shoku ushtar! . . .

DO TË DAL NGA KODRAT

(Sipas motiveve popullore)

Do të dal pa gdhirë,
Do të dal nga kodrat
Të takoj dëshmorët,
Vëllezërit dhe motrat.

Do të hyj ngadalë,
Lehtë e pa u ndier,
Në kopshtin me lule
Të lavdisë dhe nderit...

Do nis të lexoj
Plakat edhe gurët
Si qiellin me yje,
Që nuk shuhën kurrë.

Do t'iu vë mbi ballë
Lule dhe freski;
Do t'iu them ca fjalë,
Ndoshta poezi...

Ja, mes tyre erdha
Dhe dëgjoj bilbilin:
Sa e qetë, e madhe,
Bota e flijimit! . . .

Ikin, vijnë zogjtë,
Duke cicëruar,
Herë me të qarë,
Herë me të kënduar . . .

Do të dal pa gdhirë,
Do të dal nga brigjet,
Të thërres dëshmorët
Vallë mos përgjigjen . . .

Dhe përgjigjj' e tyre
Hapet nëpër këngë:
Ç'lule që ka rritur
Kjo Partia nënë! ..

Ja, prej tyre iki,
Dhe dëgjoj bilbilin:
Sa e qetë, e madhe,
Bota e flijimit! . . .

BUKURESHT, 1960

Ai vit
Nuk erdhi si të tjerët,
Si të tjerët
S'iku ai vit,
Zër' i Shqipërisë
Në shesh të kohës
Kurrë s'qe dëgjuar
Aq epik!
Shtetet
Ngriheshin nga tavolinat,
Ca të krekosur,
Ca me reveranca...
Shqipja jonë
Ngrihej lart në sallë,
Krahët
Në tavan duke përplasur.
— Jo! —
Nuk është marksizmi
Plaçkë
Që ta nxirrni në ankand,
Historia
Vendin ia ka ngritur —

Flak' e kuqe
Përmbi barrikadë!...
Mos, zotërinj,
E ngrini lart figurën,
Të na trembni
Me metal e shifra...
Forc' e gravitetit njerëzor:
Ideal i — mbi të gjitha!..
Sot,
Kjo sallë
Është kufir' i fundit:
Ju, andej —
Në gjunj të borgjezisë,
Ne, gjoks hapur,
Në piketa zjarresh —
Mes furtunave të historisë!..

J U , M E K O H Ë N ...

Ju, me kohën,
Ballë për ballë, sa herë,
Vite gjashtëdhjetë,
Jeni përleshur,
Por s'ju pashë
Me kokën varur kurrë
Dhe ta fiknit
Për një çast buzëqeshjen. .
Kjo buzëqeshja juaj,
Edhe mua,
Thellë në shpirt,
Më është reflektuar,
Ndaj unë eci rrugës
Qind për qind i lumtur,
Vërvhellej motivin:
Rrofsh, atdhe,
Që heroizmin

Nëpër shekuj s'e ke tradhtuar!...
Ndaj, dhe në shtëpi,
Kur vij nga puna
Dhe fëmijët e mi
I puth në gushë,
Gjersa bie të fle
Vazhdoj motivin:
Rrofsh, atdhe,
Që heroizmin
Nëpër shekuj s'e ke tradhtuar;
Rrofsh, atdhe,
Që sot nderon me grusht!

K O N G R E S I T V

Ku buçitët,
Vite gjashtëdhjetë,
Ku e morët
Më të fortë kumbimin?
Po,
Nga ti, Kongres i Pestë,
Ne e hodhëm dhe më tej shikimin
Ësht' Partia
Që s'të le të vyshkesh,
Ësht' Partia
Që në vend s'të le:
— Shok, pa merr njëherë
Këtë «pasqyrë»,
Shih si ishe dje
E sot si je!...
Dhe rinia
Sot, nëpër agime,
Gjumin duke lënë
Në mes të shtratit,
Ngjitet majash,
Trupin e freskon,
Në ujëvara

Veprash,
Ngjarjesh
E rrit shtatin...
Dhe rinia, sot, me hap të shtrirë,
Në asfalt të kohës po troket,
Me bori idesh
Në qiell ngritur
Tej horizontit
Na thërret:
— Eja, shok, dhe ti,
Në rreshtat tonë,
Mbushe rreshtin, shok,
Mos mbetet bosh.
Mu në ballë armikun,
Duke ecur,
Me një plumb
Mësohu ta qëllosh!..
Ndaj, Kongres,
Me krenari të quajmë
Shok plot gjallëri e plot pushtet,
Që ushtarakisht
Mes vitesh shkon
Ngjeshur
Me gjerdan e me fishekë!..

PRANË VITEVE PARTIZANE...

Kujtime fëminore!
Midis jush jam përsëri:
Rri afër partizanëve
Dhe s'dua të largohem kurrë.
Armët e tyre
Më përshëndesin me dashuri,
Dhe unë përpinqem
Të kapërcej murin e viteve:
«Kur do të bëhem burrë?»...
Kur do të hyj edhe unë
Në biseda me ta,
Kur do iè rri me ta
Kokë më kokë,
Për të bërë një plan,
Dhe,
Mbasit ta kem mbaruar,
Me shpirt t'ia marr këngës:
«Nëntëqind shtatëmbëdhjetë,
Në dëborë e në tufan»?!...
Kur do të çohem edhe unë
Herët,
Pa zbardhur mirë,

Pas yjeve partizanë
Rrugën të marr;
Sa hap sytë —
Të dukem në ndonjë kodër,
Sa mbyll sytë —
Të ngjitem në ndonjë mal?!...
Kur do të marr pjesë
Edhe unë në luftime,
Që për mua të thonë:
«Ke marrë pushkën
Lufton për liri,
Vatan»,
Kur do të vë edhe unë
Yllin në ballë,
Që të dukem:
«O i vogël,
O partizan»?!...

KËNGË PËR MUJO ULQINAKUN

Zure vend këtu, në breg të detit,
Dhe përballë detin rri, shikon,
Bisedon me të si shok i vjetër,
Që të njeh dhe gjuhën ta kupton...

Ç'thonë dallgët, Mujo, larg kur ikin,
Ç'thonë dallgët, kur drejt bregut vijnë?
Ndoshta të këndoijnë nat'e ditë
Këngën e përjetshme për lirinë...

Ç'thonë erërat, kur bregut çirren
Dhe stuhitë kur në det shpërthejnë?
Ndoshta të këndoijnë me qindra lira
Këngën e pavdekshme për atdhenë...

Ç'thonë agimet, sytë mbi det kur çelin,
Ç'thonë muzgjet, sytë kur perëndoijnë?
Ndoshta përmbi trimërinë hedhin
Qindra ngjyra që në shekuj rrojnë...

Zure vend këtu, në breg të detit,
Edhe pozicionin s'e lëshon,
Roje e përjetshme, sypafjetur,
Që hapësirën rrotull kontrollon...

SA E DUA KËTË NATË...

Natë e thellë shqipëtare,
Qielli i ëmbël, blu, mavi,
Tejpërtej me yje zjarre,
Si zemër plot dashuri...

Sa e dua këtë natë
Hapur si një frymëzim,
Ku e dridhur dhe e gjatë
Këng'e bulkthit s'ka mbarim...

Melodi' e tij e hollë,
E pushtetshme dhe e lirë
Më thërret, ma bën me dorë
Thellë, më thellë në hapësirë...

Ja, ku ra një yll nga qielli,
Me një dritë të pashuar
Dhe në këngën time erdhi,
Si një varg i frymëzuar...

Ja, një tjetër zjarr në male
Përmbi natë pushtetin shpall...
Si të ngopesh kësaj nate
Plot shkëndija, udhë zjarr? !...

Malet rrinë hijerëndë,
Sytë hapin rreth e rrotull,
Mikun e thérresin brenda,
Hasmit i pérplasin portën...

Sa e dua këtë natë
Hapur si një frymëzim,
Që i mbledh në një teh shpate
Forcën edhe dashurinë...



PEISAZH INDUSTRIAL

Dielli i mbrëmjes

Po derdh mbi Ballsh të fundit rreze.

Kollonat

Dhe oxhaqet e ngritura të uzinës së naftës

Ngrenë kryet gjer në re.

Përreth —

Masive të tjera metalesh

Dhe betoni të pamontuar,

Që duken sikur thonë:

— Na ngrini sa më shpejt edhe ne!...

Në krahë të këtyre masivëve —

Një harmoni e përsosur:

Sipër, rrëzë kodrës,

Rezervuarë gjigandë nafte,

Si një prapavijë e pashtershme,

Që pret komandën — marsh!

Poshtë —

Formacionet e para të impianteve,

Si në pozicione zjarri,

Që duken sikur thonë:

— Ne do t'i depërtojmë naftës deri në palcë!...

Në mes të këtij peisazhi —

Një rrugë e gjërë.

Ja, tani,

Mbi këtë rrugë

Dielli po humbet.

Po, midis këtij alternimi rrezesh e hijesh

Mbështet konturet e tij

Një qytet!..

Dielli i mbrëmjes

Mbi kollonat

Dhe oxhaqet e ngritura të uzinës

Po derdh të fundit rreze.

Në rrugë kalon me shpejtësi një gaz.

Brenda —

Zien një bisedë e gëzuar

Shqiptaro-kineze!..

BISEDË ME BALLSHIN E RI

1.

Tani, Ballsh,
Të gjithë epitetet midis nesh u rrafshuan,
U përzien me zhavorrin e rrugëve të tua
Dhe u ngjeshën fort,
Dhe, ashtu papritur dhe pakujtar,
Ne u gdhimë një mëngjes,
Duke iu drejtuar njëri-tjetrit
Me fjalën «shok»...
Në mes të kësaj fjale
U bë kryqëzimi i rrugëve tona:
Takim — ndarje dhe prapë — takim...
Dhe unë,
Në një nga stacionet e takimeve qëndrova
Të shkruaj për ty këto vargje,
Thjesht pa autograf dhe pa dedikim...
Kish qëlluar edhe herë të tjera
Të kaloja përmes këtyre rrugëve:
Një borë e gjatë makine,
Një nxjerrje koke
Dhe një «lamtumirë»...

Ndërsa tani

Ne trokasim shpesh në dyert e njëri-tjetrit

Duke shtypur zilen e dashurisë që pa gdhirë...

2.

Ti nuk je, Ballsh,

Skicë e një agimi, që as nga malet nuk duket,

Që ende zvariset diku larg, në horizontet pa fund.

Ti je një rrezatim, që gjer në palcë vjen e të futet,

Që të ngroh,

Të jep jetë

Dhe nga vendi të tund:

— Çohu, njeri, punëtor a inxhinier qofsh,

Dhe ti, shkrimtar,

Që ke ardhur nga meloditë e jetës i rrëmbyer...

Këto rreze shkulen nga toka

Dhe, mbi tokë duhen zbërthyer...

3.

C'janë ato drita,

Që në mes netve të tua, Ballsh, kanë lulëzuar

C'është ai konstelacion i ngjeshur yjesh det? !...

Uzinë!

Kumbim i ri në zemrën e dashuruar!

Ti m'i përfhive të gjitha këngët si një magnet!...

Ti m'i fute ato

Në spektrin e dashurisë sate të gjerë

Dhe tani ato nisen të etura,
Duke dalë nga burimet e pjesshme të poezisë
E duke rendur me vrull
Në vërshimin pranveror
Të industrializimit të Shqipërisë...

4.

Ende ti s'e ke formuar trupin tënd të plotë.
Në karkaset e tua
Vazhdon të ngjishet mishi dhe gjaku i ardhshëm, Uzinë...
Përreth trupit tënd,
Shtatë kantiere, si shtatë skulptorë,
Janë mbërthyer,
Për të të gdhendur bukurinë dhe madhështinë...
Gjëmon vallja e jetës nën këmbët e tua,
Të shtatë daltat e kantiereve
Ritmikisht në trupin tënd godasin...
E, nën këto ritme pune dhe jete,
Ditët e ardhshme,
Afrohen edhe ato,
Këmbët në valle përplasin!...

5.

Përditë, shoku im,
Tinguj të rinj burojnë nga ky vend,
Përditë më e fuqishme bëhet kënga e betonit dhe e metalit,
Por, asnje lidhje, asnje saldim

S'i nxjerr dot ato kumbime,
Që nga kontaktet ndërmjet njerëzve dalin...
Me vegla në duar, me çanta nën sjetull,
Hyjnë dhe shpérndahen në reparte
Montatorë,
Inxhinierë,
Punonjës nga Lidhja e Shkrimtarëve,
Ndërsa ti, shoku im,
Përditë shtrin përqafimet e mikpritjes punëtore,
Dhe, në këto përqafime vjen e rritet
Edhe përpunimi i thellë i èndrrave dhe idealeve!...

6.

Te ti s'kam ardhur, frysmezuesja Uzinë,
Të shtrihem i shkujdesur
Në tablo të qeta, të patundura idilike...
Në sfondet e tua lëvizëse
Edhe këngët dua të jenë në zhvillim,
Me fytyrë kthyer
Nga shkëlqimet e shumëngjyrtë të industrisë energjitike...
Drejt këtyre shkëlqimeve
Këngët dua të zgjaten e të zgjaten,
Duke ecur
E duke mbledhur qindra zëra tok...
Dhe në isot e dallgëzuara, bashkë me zërin e naftës
Dua të gjëmojnë zërat
E benzinës,

Gazoilit

A të qymyrit kok...

Nga pentagramet e këngëve

Dua vazhdimisht të ngrë kokën,

Duke përshëndetur herë me zë, herë me dorë

Qytetin e ardhshëm, mikun, dhe shokun

Industrial

Me 10 mijë banorë...

7.

Me trajtat dhe dimensionet që përditë po merr,

Dikur

Mund të të shkonte përshtat edhe fjala «kollos»...

Por, bashkë me vithisjen

E përrallave dhe miteve në humnerë,

U transformuan, Uzinë, edhe emrat,

Që ti qytetarisht mund të gëzosh...

Ndaj emrin tënd

S'do ta kërkojmë në legjenda

Apo romanca Robinsonësh,

Sepse ti s'je vetmi,

S'je pyll,

S'je shkretëtirë...

Emrin tënd

Do ta kërkojmë nëpër skeda revolucionesh,

Që mbartin me vete forcën popullore dhe dashurinë...

Emrin tënd do ta nxjerrim

Nga katalogjet e pesëvjeçarëve —
Pesëvjeçarët e epokës së Partisë...
Dhe, duke të emëruar,
Do dalim të të përshëndesim:
— Mirë se vjen, qytetarja,
Dhe ushtarakja njëkohësisht!..

8.

Tani, Uzinë,
Të gjitha epititet midis nesh u rrafshuan,
U përzien me zhavorrin e rrugëve të tua.
Dhe u ngjeshën fort,
Dhe, ashtu, bashkërisht duke u stërvitur dhe mobilizuar
Ne u gdhimë një mëngjes
Në pozicione të të njëjtit front...
Në këtë front ne të dy nuk jemi të vetëm.
Pranë nesh qëndrojnë shokë,
Të rinj,
Të fuqishëm,
Të qeshur, si vetë Shqipëria,
Që ia marrin këngës me zë të lartë, si Fierza
Dhe ia kthejnë me zë të gjerë, si Metalurgjia...
Në këtë front ne ecim
Drejt një qielli të ndritur,
Duke kaluar
Nga gjerësia e drithërave
Te lartësitë e oxhaqeve

Dhe kollonave të larta...

Në këtë front marshon e tërë Shqipëria
Nga agrarоindustrialja,
Tek industrialoagrарja
E afërtا!...

Ndaj, në këtë front,
Edhe kënga dua të mos ndalet kurre,
Por të shpërndajë si një korrier
Gëzimet e reja të Shqipërisë,
Duke rendur skaj më skaj
E duke shtypur që pa gdhirë
Zilen e dashurisë...

KËNGËT E METALURGJISË

1.

Në çdo skaj, atdhe, për mua je i dashur,

Në çdo skaj, atdhe, për mua je i vyer,

Po, në rrugën tënde të pandalshme,

N'Elbasan shikimin sot kam kthyer...

Jo se shikoj atje ca grimca jete,

Jo se puna ndonjëherë më shpie,

Po se shpesh atje dëgjoj të flasin

Në një gjuhë të re, të padëgjuar,

Gjuhë të çeliktë metalurgjie...

Kur dëgjoj të flasësh këtë gjuhë,

Një imazh të gjallë shoh në ngritje —

Shqipëria jonë ish e drunjtë,

Sot po merr fytyrë metalurgjike...

2.

Nga pikat e tua — rrugë dhe rrugë pa mbarim,

Si në një front të gjerë

Që gjer tej, në zemër të horizonteve futet...

Të përshëndes në marshimin tënd, i dyti Çlirim,

Armatë e përqëndruar drejt objektivave të kuqe!...
Me një potencial të rëndë nëpër shtigjet e socializmit
Ti del nga një fushë e zakonshme nën këmbë të Shpatit,
Duke tundur dheun përreth me peshën e marshimit
Të uzinave të shkrirjes dhe të përpunimit të metalit.

3.

Në këtë mobilizim të përgjithshëm,
Në këto marshime të largëta,
Nëpër të cilat gjoksin mbush me ajrin e së ardhshmes

Po unë ç'pikë zë, Shqipëria,

Me ç'pamje duhet të dalë ajo, e çdo hapi e pranishmja,
Muza e jetës, poezia?...

Në pikat e tua të panumërtë, një pikë, Metalurgji zë dhe

Kartëvizitë për këtë as prita, as ti më dërgove... unë.

Me të tëra dokumentat e nevojshme gati për punë,

Unë erdha te ti si një fuqi e zakonshme punëtore...

E di:

Rrugët e tua janë të gjata, të vështira,

Ashtu siç është e gjatë rruga që ndjek çdo mineral

Nga nxjerrja, shkrirja gjer te përpunimi....

Por unë jam nisur dhe s'mundem në mes të rrugës të dal

Nga marshi i këngëve të industrializimit...

4.

Në lartësitë e tua shoh punëtorë që janë ngjitur
Majë kullave, oxhaqeve, furrave qysh herët në agim,
Dhe, më ngjan sikur ata me duar i rrëmbejnë diellit dritën,

Duke zbritur me vinç në tokë

Pesh n e dit ve q  do t  vijn . . .

As shiu, as era, as ngrica ata s'i lëviz dot

As shiu, as era, as ligrica atá s'f' leve,
M' illave oxhaqeye, furrave gjer nē mbrëmje vonë,

Majë kullave, oxlaqeve, farave gë
Majaintalë e matën ata peshën e ditës që zbritën sot,

Me kuintale e maten ata pesien...
Atü tü së pesërmes do ta matin me ton...

Pärditë pesha të reja, të rënda nga rezervat e kohës:

Nië vinc shkarkon gizë, çelik, bloqe betonarmeje, nallombë të dorës.

Një tjetër shkarkon, duke mbajtur si në pëll

Nje tjetër shkarkon,
Pesha konceptesh dhe dashurish të reja...
mali

Dhe të duket në këto lartësi sikur je majë një mali,

Dhe, të duket në këtë shtrirje sikur je në një det...

Dhe, të duket në këtë shtëpi. Këtu u merren mendt interesit dhe lavdisë personale

Kētu u merren menit interest am
Die bien rrokullimthi tatépjete...

Dhe bien rrokuullinii latepjete...

5.

Die një bllok betonarmeje lart ti ngrite,

Sot një furre e veshe me çelik

Dhe me gjoksin plot me kapriata metalike

Thellë me ajër mbushe mushkëritë...

Nga kjo frymëmarrje i pushtuar,

Eci, futem mes gjëmimeve të viteve
Dhe dëgjoj, si bubullijnë hekurat e përpunuar,
Dhe shikoj se shkrepëtijnë profilet e çeliqeve!...
S'është stuhi, zgalem, që vjen nga deti,
Toka vetë është lajmëtarë,
Që njofton se hekuri së shpejti
Do të marrë vizë shqipëtare...

6.

Kjo këngë për ty nuk është prezantim,
Që ti e shquar të bëhesh nëpër gazeta dhe revista...
Ti edhe pa këtë këngë je e njohur në atdheun tim,
Siç është një punëtor i dalluar, një Hero i Punës Sociale
S'ke nevojë për himne dhe lavdi, ti Metalurgji,
Se forcën dhe shtatin nga dashuria jonë e përbashkët e
Ashtu sikurse unë këta vargje i nxora nga ti
Në një çast ndezjeje
Të bisedës sonë të përbashkët shoqërore...
Këtë bisedë unë rrugëve të atdheut e gjeta të hapur.
Dhe, s'është një këngëtar i vetëm këtu,
Po qindra këngëtarë që ia tërheqin telat lirës,
Ndaj dhe melodia vjen kështu e lirshme dhe e zgjatur,
Si vetë shpirti punëtor,
I gjerë si shtrirja e hapësirës...
Është biseda për ty, është kënga për ty,

Që u rrit nëpër lulishtet e tingujve dhe të fjalëve,
Duke e derdhur dashurinë tonë nëpër sallat e fushave,
Duke e ngritur dashurinë tonë nëpër amfiteatrot e ma-
leve...

7.

Pse je çuar herët, shokë ynë,
Dhe me shokë të tjerë rrugën larg ti paske marrë?
Mos atdheu ty për në luftim
Të ka thirrur sot në vijë të parë?!...
Mos atdheu çan ndonjë rrithim,
Ndaj i papërmabjatur ikën rrugës
Dhe, mbi kalë të kohës fluturim
Lart ngre shpatën e Partisë së Punës?!...
Po të shoh, atdhe, si rend përpara syve,
E dëgjoj si vringëllin dhe shpata
Përmbi gjerdhe, gropë, kthesa prapa shpine,
Përmbi prita, kurthe dhe bllokada...

8.

Sa të gjera rrugët e atdheut!
Sa e gjerë rrugëve miqësia!
— Shok, si je? Nga Ballshi kur u ktheve?
Si shkojnë punët nga Metalurgjia?
Po në Fierzë a ke qenë vallë?
Rrugë e gjerë plot shtigje poetike,

Thonë se andej një agim i ri do dalë
Mbushur plot reflekse, ngjyrë drite!...
Këta zëra, plot gjëzim e jetë
Rrugëve t'atdheut kur dëgjoj,
Zemra ikën, kërkon të marrë fletë,
Mendja kërkon qìll të fluturojë....
Larg e larg, në qìllin tonë të kthjellët,
Ku si diell na ndriçon Partia....
Sa të gjera rrugët e atdheut!
Sa e gjerë rruqëve dashuria!....

MOTIVE NGA FIERZA

1.

Dhjetra çaste jete, këngësh miqësie,
I lashë pas, Fierzë, duke u ngjitur nga Ballshi për te ti,
Në çdo kthesë të bjeshkëve, si me një tundje shamie,
Duke përshëndetur atdheun në lartësi!...
Ku je ti, e bukura, e panjohura, e ashpra,
Që në epizmin e maleve trupin e ke shtrirë?
Në ç'qafë mali, në këto rrugë të largëta,
Do ta hapësh si nëpër legjenda syrin?...
Por, ç'ta kërkoj nëpër legjenda bukurinë,
Kur zemra kaq afër e ndien: ja, po del!
Përpara — Drini i shtrirë me tërë natyrshmërinë...
Përreth — lugina, male, qiell...

2.

Sa, në shtratin tënd, legjenda edhe ëndrra
Ke përkundur, Drin i mocëm, Drin i gjatë?
Sa gjëmime malesh, pushkësh, këngësh,
Ke rrëmbyer poshtë ti nëpër shtrat?...
Huqin tënd të egër ne ta dimë:

Je i rreptë, i vrullshëm, dredharak,
Ndaj luginës mijëra krahë e mendje vijmë,
Të të ndalim, të të bëjmë zap!...
E dëgjon një këngë të re, që vjen nga brigjet?
S'është kreshnik i vetëm që këndon menatë,
Kënga e atdheut lart, drejt teje ngjitet
Me fuqi 400.000 kilovat...
Dhe gjëmojnë tingujt tejembanë luginës,
Er' e malit lart i ngre më shumë,
Bjeshkët tund marshim' i socializmit;
— Dhe këtu jetoj, hedh hapin unë!...

3

Jo, natyrë të pagdhendur, Drin, s'të lëmë,
Që si gjarpër të rrëshqasësh poshtë, si zvaranik,
Duke fshehur nëpër zaje gjurmët, vrullet, shpresat,
Duke ndrydhur nëpër lym gjithë energjitë...
Energjité e tua, ja, këtu shkarkoi,
Mos u lidh me kokëfortësi prej pele,
Frerin ne ta kemi hedhur mu në gojë,
Lidhur fort në këta dy tunele...
Urdhrit tonë të prerë ti do t'i bindesh:
Ule kokën, Drin, dhe mos u ndje!
A s'dëgjon se si në ajër hidhen
Mijëra metra kub gurë e dhe?...
A s'dëgjon se si makinat ziejnë,

34

A nuk sheh si dritat hapin sytë mbi lumë
Dhe një dashuri të re nëpër damarë ndiejnë:
«O, kjo an' e lumi, ka lëvizje shumë?!...»

4.

Përsëri gjëmojnë minat poshtë e lart luginës.
Do të thotë se punëtorët
Përsëri me zjarr shkëmbenjtë po ndezin,
Eksploziveve, si luleve, duke u thithur
Gjithë freskin' e tyre të mëngjesit...
Merr dhe ti nga kjo freski, o kënga ime:
Minë në tokë, në frymëzime minë!...
Ja, u ndez fitili! Kokat ulni!
Ti gjëmo në vargje, socializmi ynë!
Ti gjëmo, hidrocentral i Matit,
Vau i Dejës të dërgon të fala...
Shokë të vjetër, dilni, pritni mikun,
Shpejt ai i Fierzës del përpara!...
Dil dhe ti përpara, kënga ime,
Posi rrymë bridh në telat, shtyllat tonë
Dhe thërrit nga maja më e lartë:
— Rryma ecën,
Qarku i socializmit zien nga elektronet!..

5.

Edhe në majën tënde, Fierzë, do të ngremë një flamur —
Piketë e re e rrugëve nëpër të cilat atdheu kalon,

Ku këta vargje do të dëshiroja të shërbenin si një mur
Prej nga njeriu zgjat kokën dhe shikon...
S'duhen as gjyslykë këtu e as dylbi.
Me sy të zhveshur njeriu tërë rrugën e pushton.
Si një udhëtar i palodhur që po hyn në thellësi
Socializmi ecën drejt një të riu stacion...
Tridhjetë vjet mbushi ai duke udhëtuar e udhëtuar
Nëpër rrugët ku fryjnë dy fllade — liria dhe e drejta,
Asnjëherë në ecje e sipër pa u rrëzuar,
Mbështetur fort në këmbët e veta!...

6.

Që nga Ballshi gjer këtu, në Fierzë,
Jeta, posa shok, më mori pas
Dhe në një rrugë më ktheu...
Por, sa itinerare ka të tjera,
Që përshkojnë tejembanë atdheun!...
Sa të tjera rrugë, të tjera shtigje,
Drejt stacionit Komunizëm do të derdhen!...
Njerëzit do të futen midis tyre,
Lulet më të bukura të zgjedhin...
Ja e verdha — det me lule dielli,
Ja e bardha — oqean pambuqesh...
Socializmi tokën do ta ndezi
Plot me vepra — breza lulëkuqesh!...

S A Z A N I

Sérish Sazani u vesh me kapotën e murme të mbrëmjes,
Po konturet e tij vazhdojnë ta përshëndesin që larg
Edhe këtë kavaleri anijesh,
Që duken sikur shkarkojnë pajimet e rënda,
Edhe këtë ushtri të gjatë njerëzish,
Që janë ulur pistave të hanë darkë...
Kështu gjithmonë ke qëndruar, Sazan,
Roje e mbrëmjeve të argjendta, roje e agimeve të arta,
Ushtar pararojë, që mbi shpinën tënde mban
Barrën më të rëndë që la dita,
Barrën më të rëndë që nxori nata...
Ja, edhe sot qëndron pranë nesh, ushtar si përherë,
Hyn në intimitet tonë,
Në këngët,
Në dashuritë tonë
Dhe buzëqesh....
Dhe prapë tendosesh e tendosesh në hapësirën e gjerë,
Me syrin në pushkë,
Me kufjet në veshë...
Ne rrimë e dëfrejmë:

Gëzimin e ditës shpërndajmë nëpër det,
Të gjithë kjo mbrëmje e argjendtë
Na fton për jetë e dashuri.
Por, çdo lëvizje, çdo fjalë, që hyn me këtë mbrëmje në
një kontekst
Kthyer është, Sazan, me fvtyrë nga ti...

E DIMË, VIETNAM...

E dimë, Vietnam, ti trüpин e ke ende të përgjakur
Dhe shkrumbi s'të është hequr nga flokët, nga balli,
gerpikët, e dimë.

Ndaj nc, shqiptarët, me tërë ujët e burimeve dhe
shkumën e detit do të donim t'jua spërkatnim
Dhc plagët tuaja, dhe dhembjet, dhe nxchtësinë...

E dimë, Vietnam, ti sot ke më të madhen festë,
Ndaj ne, shqiptarët, në përshëndetje do të donim t'ju
dërgonim të gjitha krismat e armëve,

Që nga e djeshmjë, e sotmja e deri tek
Fitorja e fundit e proletarëve...

Dje, më 1 Maj, më të gëzuar e pasët në sheshin e
Tiranës Skënderbenë...

Në çast m'u duk sikur kaloi përmes nesh si ndonjë fatos
i bardhë

Dhe, në mes qindra fishekzarrëve dhe yjeve që dukeshin
sikur merrnin dhenë,

Ai nisej për në dasmën tënde, Vietnam, i përgjakur
mbi kalë...

Dje, më 1 Maj, më i gëzuar Enveri, në tribunë qëndronte
Gëzimi i tij i madh s'kish e s'kish fund...

Herë dukej sikur uloj dhe tërë fëmijët e botës përqafonte.

Herë, sikur ngrihej dhe godiste agresorët me grusht...
Dje, më 1 Maj, edhe gazetat dolën më të gëzuara se

përhcrë,

Shkronjat e tyre dukeshin sikur kishin marrë flatra
Dhe, me një shpejtësi të paparë, shpërndanin e shpër-
ndanin në q'Neill
Qindra ylberë të idealeve të zjarrrta!...
E dimë, Vietnam, ti sot ke më të madhen festë,
Ndaj, ne shqiptarët, në përshëndetje do të donim t'ju
dërgonim të gjitha krismat e armëve,
Që nga e djeshmjë, e sotmja e deri tek
Fitorja e fundit e proletarëve...

RRËZË MALIT KA RËNË QETËSIA...

Rrëzë malit ka rënë qetësia e gjerë e natës.
Shtrirë janë në heshtje yjet, toka, qielli blu.
Vetëm ndonjë zile e hollë përcjellë ëmbël gjumin e
fshatit
Dhe ndonjë lopë, që nxjerr trashë notën «muuuu»..

Erëra lulesh, bimësh, drithërash treten në hapësirë
Përzier me freskin' e krojeve, përrrenjve, burimeve
Dhe ndien njeriu nëpër trup se bashkë me to janë shkrirë
Edhe krojet e ndjenjave dhe të mendimeve...

Nesër tërë kjo qetësi e gjerë do të çohet në këmbë,
Këndej do të derdhet fushave, andej do të qepet maleve,
Ndërsa unë, miku i ardhur, s'ngopem tërë këtë natë me
hënë

Duke shirë si grurin në lëmë kallinjtë e fjalëve...

Tej, në kodër, një tjetër qytetar ende s'e zë gjumi.
Ja, përsëri në mes qetësisë së natës fjalën ai mori:
Me kërcitje, gjëmimë e zhurmë duke nisur turnin
Hedh hapin arave, miku i fshatit-traktori!...

Ecën dhe ndalon, merr fuqi të reja e prapë lëviz,
Trupi i hidhet përpjetë, sytë në terr i shkrepëtijnë...
Unë e shikoj dhe dua t'i thérres nga sinoret e poezisë:
— Jepi, vëlla, jepi, t'ia rrëmbejmë kësaj nate bukurinë!...

VARGJE PËR MUZAT

E bukur është miqësia me muzat,
Po muzat
Jo të gjitha të bukura janë.
Njihen, për shembull, muzat — bija
«Modernioza»,
«Futura»,
E Cetera...
Të gjitha pjella
Të muzës — nënë: «Filistianë»..
Përdridhen këto muza,
Kush të shkëlqejë më shumë,
Disa synojnë
Të pushtojnë vetëm një ishull,
Të tjerat
Tërë botën.
Njëra kërkon
Ta arrijë lavdinë patjetër për së gjalli,
Tjetra,
Së paku,
Edhe «post-mortum»...
Por ka edhe një muzë tjetër.
Atë,

Në mes njerëzve,
Nga bjeshkët e historisë
Proletarët e prunë;
Ajo s'do të veçohet,
Por të shkrihet në jetë
Me këngë,
Me luftë,
Me punë...
Kjo është muza «Komunë»...
Dhe gjetkë
E ka gjetur ajo
Dhe forcën,
Dhe gëzimin,
Dhe bukurinë...
Motua e saj —
Jo t'ua rrëmbejë njerëzve,
Por t'ua dhurojë atyre dashurinë.

PËRMBAJTJA

Gatishmëri	3
Do të dal nga kodrat	5
Bukuresht, 1960	7
Ju, me kohën	9
Kongresit V	11
Pranë viteve partizane	13
Këngë për Mujo Ulqinakun	15
Sa e dua këtë natë	16
Pëisazh industrial	18
Bisedë me Ballshin e ri	20
Këngët e metalurgjisë	27
Motive nga Fierza	33
Sazani	36
E dimë, Vietnam	39
Rrëzë malit ka rënë qetësia	41
Vargjet përmuzat	43

Tirazhi 1000 kopje

Format 70x100/32

Stash: 2204-72

KOMBINATI POLIGRAFIK, Shtypshkronja e Re
Tiranë, 1976